

kanë varrosur në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata T.A, FDH-17265; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256; *Identity of Five Other Albanians, Killed in Drenica, Made Known*, pasqyra e lajmeve, KIC, 26.09.1998, FDH-33990; *Serb Offensive in Drenica Steps Up, Many Albanians Killed and Slain*, pasqyra e lajmeve, KIC, 26.09.1998, FDH-33990.

## Fidan (Jetullah) Bekaj

(24.01.1982, shqiptar nga Likoci/Likovac, komuna e Skënderajt/Srbica, nxënës)

Fidani me motrat, prindërit dhe familjet e axhëve e braktisën fshatin më 7.08.1998, kur forcat serbe kanë hyrë në Likoc/Likovac. Shkuan me traktorë në Baks, ku gjendeshin shumë refugjatë nga fshatrat përreth. Më 22.09.1998, kaluan në bjeshkën e *Çiçavicës/Çiçavica*. U ndalën në fushë pranë fshatit **Krasmiroc/Krasmirovac**, ku u strehuan shumë refugjatë të tjerë me traktorë. Në mëngjesin e datës **24.09.1998**, rreth orës 10:30, ushtarët serbe me kokat e lidhura me shami dhe fytyra të ngjyrosura e rrethuan fushën. E ndërmorën bastisjen e refugjatëve, u morën të gjitha gjërat e vlefshme dhe, më pas, u urdhëruan që të shkonin drejt Krasmirocit/Krasmirovac. Një ushtar e ndau Fidanin nga kolona. I ati e luste ushtarin që ta lëshonte atë, duke thënë se Fidanin e kishte djalë hasreti dhe se ai ishte shumë i ri. Ushtari reagoi duke e qëlluar me kondak në kokë. E çuan Fidanin në pyll, ndërkaq civilëve u thanë që të hynin në një zgafelle. I ati i Fidanit sërish e luti një ushtar tjetër që t'ia lëshonin të birin. Ky ushtar e mori letërnjoftimin e Fidanit dhe shkoi në pyll. Por, u kthye shpejt duke i thënë babait të Fidanit se “djali ka mbaruar.” Pastaj, ushtarët i lëshuan civilët që të shkonin. Kur arritën në Baks, disa të afërm u thanë se e kishin parë trupin e Fidanit në pyll. Një ditë më vonë, babai i Fidanit dhe një i afërm i tij shkuan në pyll, e morën trupin e djaloshit dhe e varrosën në fshatin Gradicë/Gradica. Pas lufte, më 14.04.2000, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Fidanit në varrezat e Likocit/Likovac.

**Burimet:** deklarata G.B, FDH-14522; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë),

Ex.5D00755, FDH-33256; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 136, FDH-23857.

## Adem (Ajete) Lushtaku

(15.10.1959, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor, shtatë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Ademi me familje jetonin në *Mëhallën Lushtaku* në Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze. Punonte në kooperativën bujqësore *Produkt* në Skënderaj/Srbica. Ka aderuar në UÇK më 10.04.1998. Kur forcat serbe e nisën sulmin më 22.09.1998 në zonën e bjeshkës së *Çiçavicës/Çiçavica*, Ademi e ka strehuar familjen te daja Smajl Bunjaku në Krasmiroc/Krasmirovac. Ai me ushtarë të UÇK-së ndenjën në fshat. Gjatë dy ditëve në vijim, Ademi ka marr pjesë në luftimet me forcat serbe në *Çiçavicë/Çiçavica*. Ka rënë më **24.09.1998** në pyllin e fshatit **Krasmiroc/Krasmirovac**. Një ditë më vonë, daja Smajli me disa banorë të fshatit e kanë marrë trupin e Ademit dhe e kanë varrosur në varrezat e Krasmirocit/Krasmirovac. Pas lufte, më 20.12.1999, mbetjet mortore të Ademit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Polac/Poljance.

**Burimet:** deklarata Xh.L, FDH-31867; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

## Rajko (Rade) Radovanović

(12.03.1973, serb nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica, i pamartuar, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

## Miroslav (Radoman) Slović

(14.11.1974, serb nga Prijepola, i pamartuar, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Miroslavi dhe Rajko punonin në polici nga viti 1996 – Miroslavi në stacionin policor të Zubin Potokut, ndërkaq Rajko në SHPB-në e Skënderajt/Srbica. Ishin në përbërje të NJPP. Në datën **25.09.1998**, nga ora 16:45, Rajko dhe Miroslavi me një grup pjesëtarësh të NJPP-së po kalonin me makinën nëpër **Obri të Ulet/Donje Obri-nje**. Hasën në pritën e pjesëtarëve të UÇK-së. Rajko dhe Miroslavu u vranë në vend, ndërkaq pesë policë të tjerë u plagosën.

**Burimet:** SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 56, 63; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Te-*